


A mund të na dëgjoni përmes ekranit? TË RINJTË PËR NJË HAPËSIRË TË SIGURT NË INTERNET!

NDËRHYRJA E SHTETIT/QEVERISË: ÇFARË MUND TË BËJNË QEVERITË KOMBËTARE?


Të miratojnë zgjidhje ligjore që do të rregullojnë hapësirën e internetit. Një rregullim i tillë mund të adresojë gjuhën e urrejtjes në internet dhe bulizmin online, të rregullojë portalet online të lajmeve dhe platformat e mediave sociale.




Të identifikojë dhe sanksionojë autorët dhe individët që rrezikojnë të drejtat e përdoruesve të tjerë, ata që përhapin gjuhë urrejtjeje, lajme të rreme dhe dizinformata.



Dilemat dhe çështjet e mundshme nëse intervenon qeveria



Qeveritë mund të tejkalojnë kompetencën e tyre! Është e rëndësishme të mos lejohet që qeveria të censurojë fjalën e lirë, me arsyetimin e luftimit të lajmeve të rreme.



Aktorëve dhe institucioneve politike u mungon vullneti për të marrë masa për zbatimin e ligjeve ekzistuese apo edhe krijimin dhe miratimin e ligjeve të reja.



Mungesa e besimit tek institucionet! Për shkak të veprimeve ose ndërmarrjes së masave të pamjaftueshme për të luftuar lajmet e rreme, pjesëmarrësit nuk kanë besim në institucionet e shtetit.

Këto konkluzione dhe rekomandime bazohen në gjetjet nga eventet e konsultimit për të rinjtë, i krijuar për të kuptuar përvojat personale të të rinjve në internet, pozitive ose negative, dhe mendimet e tyre se cilat masa politike dhe cilat palë të interesuara/aktorë duhet të zbatojnë këto masa për të përmirësuar përvojën e përdoruesve.

Eventet e konsultimit për të rinjtë janë pjesë e projektit "Krijojmë të ardhmen së bashku: BE-ja dhe Ballkani Perëndimor nga perspektiva e të rinjve", financuar nga Agjencia Evropiane për Politikën Kulturorë, Arsimore dhe Audio-Vizuale përmes programit të saj "Evropa për Qytetarët".